# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-472160**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Nuk mësohesh kurrë me këtë humbje”/ Odeta Gjevori rrëfen dhimbjen pas humbjes së bashkëshortit |
| ADRESA | `https://piranjat.al/showbiz/nuk-mesohesh-kurre-me-kete-humbje-odeta-gjevori-rrefen-per-bordo-dhimbje-i106215` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 17:02:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 16:51:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bba2594d3d6addbc96f6c50d244690b8c1ac974ebc0b21fa006a6e8ef1e4fb31` |
| TEKSTI | `2788dd2f36cc4cc8cbad1a6c792cd498e67f9bd26d6eb388ea22e05b39be523c` |
| PAMJA | `5bcf7bdb7a1920867fe4f22af24403eab73cf40acab63b0e1176e632ef11e857` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f6cadab27b7153d17ecd810e10a6008ddb8c6a521442ec754f7df17c0f40f109` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f6cadab27b7153d17ecd810e10a6008ddb8c6a521442ec754f7df17c0f40f109`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Flash: 49-vjeçari i jep fund jetës në Shtetasi Agron Llapushi, ■ në Elbasan, Elbasan. Për shkak të ■ Zbardhet ngjarja ka përfunduar me të shtëpa ■ Gramshit, plagosen automjete janë përplasur ■ të ri të SHBA-ve në Shteteve të Bashkuara të Amerikës në ■

SHOWBIZ

# “Nuk mësohesh kurrë me këtë humbje”/ Odeta Gjevori rrëfen dhimbjen pas humbjes së bashkëshortit

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 18:51



Gazetarja e njohur Odeta Gjevori ka ndarë një nga rrëfimet më personale, ku ka folur për një prej periudhave më të vështira të jetës së saj, humbjen e bashkëshortit dhe përgjegjësinë për të vijuar përpara si nënë e vajzës së saj, Hanës.

E pyetur se çfarë i ka mësuar kjo humbje për forcën që ka një grua, Odeta u shpreh se në momente të tilla nuk ka shumë alternativa: ose qëndron në dëshpërim, ose zgjedh të vazhdojë jetën.

“Që të mos dorëzohemi kurrë, sepse kemi dy alternativa: ose do qurravitemi dhe do mbetemi në atë pjesën e dëshpërimit, ose do ecim përpara”, rrëfeu ajo.

Për Odetën, një nga arsyet më të forta për të mos u dorëzuar ishte vajza e saj. Në momentin e humbjes, Hana ishte vetëm dy muajshe dhe gazetarja tregon se pikërisht përgjegjësia për të e shtyu të gjente forcën për të vazhduar.

“Unë u mundova të eca përpara sepse kisha dhe një arsye tjetër: kisha Hanën. Kështu që nuk duhet të ecja për veten time, po duhet të ecja më tepër për vajzën time”, tha ajo për bordo.

Gjatë intervistës, Odeta dha edhe një mesazh të fortë për gratë që mund të përballen me një situatë të ngjashme. Sipas saj, shkollimi, pavarësia dhe ndërtimi i një karriere janë ndër investimet më të rëndësishme që një grua mund të bëjë për veten.

“Çdo investim tek vetja është patentë ose siguri, është si puna e atyre agjencive të sigurimit për veten tënde. Sado e fortë të jesh si grua, prapë e do një mbështetje. Mendoj që nuk mësohet kurrë me këtë humbje. Është e sigurt. Por që duhet përshtatur”, tregoi Odeta.

Një tjetër pjesë e ndjeshme e rrëfimit ishte ajo për vajzën e saj, Hanën, sot 5 vjeçe e gjysmë. Odeta shpjegoi se nuk ka dashur t’i japë vajzës një shpjegim të imponuar për mungesën e të atit, duke zgjedhur që ajo ta kuptojë situatën gradualisht dhe natyrshëm.

“Hanës nuk ia kam shpjeguar fare, sepse Hana është një moshë shumë delikate. Në momentin që më ka ndodhur kjo fatkeqësi, Hana ka qenë vetëm 2-muajshe dhe nuk e ka konceptin e prindit tjetër. Nuk dua që të ndikoj në psikologjinë e saj, jam shumë e kujdesshme. Sigurisht që çdo gjë do vijë me kohë. Ajo do ta mësojë gjatë kopshtit, gjatë shkollës, do t’i kuptojë gjërat, por ta kuptojë natyrshëm, s’kam pse e ndikoj unë”, tha Odeta Gjevori.

## Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 26 Shtator18:05

["Rikthimi lidhet me shumë arsye"/ Princi Harry kthehet në Britani: Fëmijët janë të lumtur në shkollë]

Princi Harry ka shprehur kënaqësinë për rikthimin e tij në Mbretërinë e Bashkuar, pas gjashtë vitesh jetese në Kali...

SHOWBIZ 26 Shtator17:40

[Hyseni "fikte" radarët për Agasin, këngëtarja ironizon: Vlora dëshmoi që të jesh k*çkë mund të jesh shëmtirë dhe me post drejtues]

Fikja e radarëve të shtetit nga Vlora Hyseni për Ergys Agasin prej ditës së djeshme është vënë në qend&...

SHOWBIZ 26 Shtator16:31

[A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale]

At Nikolla Xhufka ka qenë i ftuar në emisionin "She's On Air", ku është vendosur përballë pyetjeve pikante t&eum...

SHOWBIZ 26 Shtator16:24

[Vizita e Dua Lipës në Pejë surprizë për të ftuarit! Këngëtarja merr pjesë në dasmën familjare në mesin e traditave kosovare]

Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Dua Lipa, është shfaqur së fundmi në një vizitë në Pejë duke ...

SHOWBIZ 26 Shtator16:19

[Marina Vjollca shkëlqen në Milano Fashion Week, e shoqëruar nga Ghetto Geasy në sfilatën e Elisabetta Franchi]

Milano Fashion Week ka mbledhur emra të njohur të modës dhe showbiz-it ndërkombëtar, mes të cilëve këtë herë i...

SHOWBIZ 26 Shtator15:31

[Gruaja që akuzoi Jay-Z për sulm seksual tërheq akuzat? "Nuk e kam takuar kurrë"]

Gruaja që në vitin 2024 akuzoi Jay-Z për përdhunim ka tërhequr zyrtarisht pretendimet e saj, duke deklaruar në një dokument...

SHOWBIZ 26 Shtator15:23

[Probleme të reja për Ed Sheeran, anulohen dy koncerte? Ja arsyeja]

Ed Sheeran është përballur me një tjetër pengesë gjatë turneut të tij "Loop", pasi dy koncertet e planifik...

SHOWBIZ 25 Shtator22:58

[FOTO/Një dasmë si në filma! Damiano David dhe Dove Cameron i thonë "Po" njëri-tjetrit në zemër të Toskanës]

Damiano David, ish-frontmeni i Måneskin, dhe këngëtarja e aktorja amerikane Dove Cameron i kanë dhënë fund beqarisë n&e...

SHOWBIZ 25 Shtator20:30

[Pak ditë pas humbjes së të vëllait, modelja e njohur përjeton një tjetër moment ankthi]

Pak ditë pas vdekjes tragjike të vëllait të saj, Presley Gerber, modelja dhe aktorja Kaia Gerber është përballur me një ...

SHOWBIZ 25 Shtator20:03

[Përmendi surrogacinë dhe birësimin për tu bërë nënë/ Selena Gomez tregon planet e së ardhmes për të pasur një fëmijë]

Selena Gomez prej vitesh ka qenë në qendër të opinionit publik në lidhje me deklaratat e saj për dëshirën për tu b&...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 26 Shtator

[E TRISHTË/ Këta janë Flori dhe Florida, vëlla e...]

Personat që shihni në foto janë Flori dhe Florida Hoxha, motër e vëlla, të cilët humbën jetën tragjikisht pas shp...

AKTUALITET 25 Shtator

[Zbardhet lista/ 44 restorantet ku u tregtua dja...]

Pas alarmit të dhënë për hyrjen në Shqipëri të një loti të kontaminuar djathi "Brie" nga Italia, zbardhet nga media...

AKTUALITET 26 Shtator

[Operacion i befasishëm i SPAK/ Arrestohet në Sh...]

Policia e Shtetit dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, nën drejtimin e SPAK, kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Muri i Lart&e...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!]

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**



**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.